- komunikim të qartë dhe të qëndrueshëm para, gjatë dhe pas aktiviteteve;
- struktura mbështetëse të dukshme dhe lehtësisht të aksesueshme;
- ndjeshmëri ndaj dinamikave të pushtetit brenda grupeve ndërkombëtare dhe multikulturore.

Në vend që të supozojnë se lëvizshmëria është në vetvete gjithëpërfshirëse, punonjësit e rinisë duhet të vlerësojnë në mënyrë kritike se kush përfiton nga mundësitë e lëvizshmërisë dhe ku duhet të gjejnë mekanizma shtesë për të mundësuar pjesëmarrje të drejtë dhe përvoja kuptimplota të të nxënit.

1.5 Pyetje reflektuese

Për të mbështetur të nxënit reflektues dhe zbatimin praktik të koncepteve, trajnerët inkurajohen t'u kërkojnë pjesëmarrësve të reflektojnë mbi pyetjet e mëposhtme:

- Kush ka më shumë gjasa të marrë pjesë në aktivitetet e mia? Kush mungon?
- Çfarë supozimesh bëj për disponueshmërinë, burimet dhe aftësitë e të rinjve?
- Cilat aspekte të projektimit të aktivitetit tim mund të përjashtojnë në mënyrë të paqëllimshme disa grupe?
- Si mund të kaloj nga mendimi i bazuar në barazi te praktika e bazuar në drejtësi?

Këto pyetje shërbejnë si një urë konceptuale midis teorisë dhe praktikës dhe përgatitin pjesëmarrësit për një eksplorim më të thellë të lenteve të përfshirjes, mbrojtjes, metodave të angazhimit dhe projektimit gjithëpërfshirës në modulët e mëposhtëm.

2. Lentet e përfshirjes në praktikat e punës rinore

Ky modul synon të:

- prezantojë lentet kryesore të përfshirjes që janë të rëndësishme për praktikën e punës rinore;
- mbështesë pjesëmarrësit në identifikimin e barrierave strukturore dhe kontekstuale me të cilat përballen grupe të ndryshme të rinjsh;
- forcojë aftësinë e punonjësve rinorë për të analizuar pjesëmarrjen nga një perspektivë ndërsektoriale (intersectional);
- inkurajojë qasje të ndjeshme ndaj kontekstit dhe jo-stereotipike ndaj përfshirjes.



Puna rinore gjithëpërfshirëse kërkon të shkojë përtej një kuptimi të përgjithshëm të “të rinjve” dhe të njohë faktin se grupe të ndryshme përjetojnë forma të ndryshme dhe të ndërthurura përjashtimi. Lentet e përfshirjes ofrojnë një kuadër praktik për analizimin e mënyrës se si faktorët socialë, ekonomikë, gjeografikë dhe personalë ndikojnë në aksesin e të rinjve ndaj mundësive dhe në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë në aktivitetet e punës rinore.

Në këtë modul, lentet e përfshirjes nuk paraqiten si kategori apo etiketa të ngurta, por si mjete analitike që mbështesin një praktikë reflektuese dhe të përgjegjshme të punës rinore. Ato i ndihmojnë punonjësit rinorë të identifikojnë herët rreziqet e përjashtimit dhe të përshtatin aktivitetet në përputhje me rrethanat.

2.1 Kuptimi i i lenteve të përfshirjes

Lentet e përfshirjes i referohen perspektivave që ndihmojnë punonjësit rinorë të shqyrtojnë kush përfshihet, kush përjashtohet dhe pse. Ato inkurajojnë profesionistët të shikojnë përtej pjesëmarrjes sipërfaqësore dhe të marrin në konsideratë barrierat themelore që mund t’i pengojnë të rinjtë të kenë akses ose të përfitojnë nga aktivitetet e punës rinore.

Përdorimi i lenteve të përfshirjes i mbështet punonjësit rinorë të:

- njohin barrierat strukturore dhe sistemike;
- shmangin qasjet "një model për të gjithë";
- projektojnë aktivitete që i përgjigjen konteksteve reale të jetës;
- parandalojnë përjashtimin e paqëllimtë.

Praktika gjithëpërfshirëse e punës me të rinjtë thekson se qasjet e përfshirjes duhet gjithmonë të aplikohen në mënyrë fleksibile dhe kritike, duke shmangur supozimet ose përgjithësimet për individët ose grupet.

2.2 Të rinjtë NEET (jo në arsim, punësim ose trajnim)

Të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim shpesh përballen me disavantazhe të shumta dhe të grumbulluara. Megjithatë, statusi NEET nuk duhet trajtuar si një identitet i fiksuar apo si një mangësi individuale. Përkundrazi, ai pasqyron një gamë të gjerë situatash të ndikuara nga faktorë socialë, ekonomikë, shëndetësorë dhe institucionalë.

Pengesat për pjesëmarrje

Të rinjtë NEET mund të përballen me pengesa të tilla si:

- besim i kufizuar në institucione për shkak të përvojave negative të mëparshme;
- vetëbesim i ulët dhe frikë nga dështimi;
- kufizime ekonomike dhe mobilitet i kufizuar;
- mungesë informacioni të qartë dhe të aksesueshëm mbi mundësitë ekzistuese;



- stigmatizim i lidhur me statusin e tyre.

Qasjet tradicionale të ndërgjegjësimit dhe kërkesat formale për pjesëmarrje shpesh dështojnë në arritjen efektive të të rinjve NEET, duke rritur rrezikun e përjashtimit.

Implikimet për praktikën e punës rinore

Ja çfarë përfshin praktika gjithëpërfshirëse me të rinjtë NEET:

- përdorimi i mënyrave informale dhe joformale të komunikimit;
- prioritetizimi i ndërtimit të marrëdhënieve dhe besimit mbi rezultatet e menjëhershme;
- ofrimi i pikave hyrëse me prag të ulët për pjesëmarrje;
- njohjen e rrugëve jo-lineare të angazhimit.

Suksesi në këtë kontekst nuk ka të bëjë me pjesëmarrjen apo produktet, por me rritjen e vetëbesimit, riangazhimin dhe fuqizimin gradual të të rinjve për të marrë kontroll mbi rrugët e tyre personale dhe profesionale.

2.3 Rinia rurale

Të rinjtë që jetojnë në zona rurale mund të përballen me disavantazhe strukturore që lidhen me izolimin gjeografik, aksesin e kufizuar në shërbime dhe një dukshmëri më të ulët në politikat rinore dhe planifikimin e programeve. Përjashtimi rural shpesh është më pak i dukshëm sesa forma të tjera përjashtimi, por ka ndikime të mëdha në mundësitë për pjesëmarrje aktive dhe të qëndrueshme.

Pengesat për pjesëmarrje

Barrierat më të zakonshme për të rinjtë në zona rurale përfshijnë:

- transport publik të kufizuar ose të pasigurt;
- distanca të gjata drejt aktiviteteve rinore;
- mungesë hapësirash rinore lokale dhe mundësish të organizuara;
- sfida në lidhje me lidhjen digjitale dhe aksesin në internet;
- kosto më të larta financiare dhe kohore për pjesëmarrje.

Këto pengesa mund të dekurajojnë angazhimin e qëndrueshëm, veçanërisht në aktivitetet e krijuara kryesisht për kontekstet urbane.

Implikimet për praktikën e punës rinore

Puna rinore gjithëpërfshirëse për kontekstet rurale kërkon:

- qasje të decentralizuara ose të lëvizshme të punës rinore;



- orare fleksibile të përshtatura me realitetet lokale;
- formate hibride ose të kombinuara të pjesëmarrjes, kur është e përshtatshme;
- bashkëpunim me aktorë lokalë, shkolla dhe hapësira komunitare.

Projektimi gjithëpërfshirës inkurajon përshtatjen e programeve në kontekstet rurale, në vend që të presë që të rinjtë ruralë të përshtaten me struktura të orientuara nga qyteti.

2.4 Të rinjtë me aftësi të kufizuara

Puna rinore gjithëpërfshirëse adopton një kuptim social të aftësisë së kufizuar, duke pranuar se përjashtimi shpesh nuk buron nga vetë aftësia e kufizuar, por nga barrierat mjedisore, strukturore dhe qëndrimore. Pjesëmarrja nuk kufizohet nga aftësia e kufizuar në vetvete, por nga mënyra se si aktivitetet dhe hapësirat projektohen dhe organizohen.

Pengesat për pjesëmarrje

Të rinjtë me aftësi të kufizuara mund të përballen me barrierat të tilla si:

- pengesa fizike në ambiente dhe ndërtesa;
- mungesë e formateve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit;
- supozime të gabuara mbi kapacitetin ose aftësinë për të marrë pjesë;
- mungesë të përshtatjeve të arsyeshme;
- përfaqësim të kufizuar në aktivitetet rinore.

Shpesh, përjashtimi ndodh pa qëllim, si pasojë e mungesës së konsiderimit të aksesueshmërisë që në fazën e planifikimit.

Implikimet për praktikën e punës rinore

Praktika gjithëpërfshirëse e punës rinore përfshin:

- projektimin e aktiviteteve duke pasur parasysh aksesueshmërinë që nga fillimi;
- ofrimin e formateve dhe roleve të shumta për pjesëmarrje;
- t'u jepet pjesëmarrësve mundësia të shprehin dëshirat e tyre për pjesëmarrje pa ide të parapërgatitura;
- respektimin e autonomisë, dinjitetit të tyre dhe vendimeve që ata marrin për veten e tyre.

Përfshirja nuk nënkupton uljen e pritshmërive; përkundrazi, ajo synon heqjen e barrierave të panevojshme që pengojnë pjesëmarrjen kuptimplotë.

2.5 Gjinia dhe Diversiteti

Lentet e gjinisë dhe diversitetit adresojnë përjashtimin që lidhet me identitetin gjinor, orientimin seksual, përkatësinë etnike, fenë, sfondin migrator, si dhe aspekte të tjera të identitetit personal.



Diskriminimi në këto fusha është shpesh i fshehtë dhe i integruar në ndërveprimet e përditshme, normat e grupit dhe praktikat institucionale.

Pengesat për pjesëmarrje

Të rinjtë që përballen me përjashtim bazuar në gjini ose identitet mund të përjetojnë:

- stereotipe dhe mikroagresione;
- mungesë përfaqësimi ose dukshmërie;
- frikë nga diskriminimi ose ngacmimi;
- mjedise të pasigurta ose jo mikpritëse;
- kufizime kulturore ose familjare.

Dinamikat e pushtetit brenda grupeve mund të ndikojnë më tej në nivelin e pjesëmarrjes, si dhe në aksesin ndaj roleve drejtuese ose proceseve vendimmarrëse.

Implikimet për praktikën e punës rinore

Praktika gjithëpërfshirëse kërkon nga punonjësit rinorë të:

- krijojnë mjedise ku identitetet e ndryshme respektohen dhe vlerësohen;
- përcaktojnë pritshmëri të qarta të sjelljes dhe marrëveshje grupore;
- adresojnë sjelljet diskriminuese në mënyrë të menjëhershme dhe konstruktive;
- sigurojnë përfaqësim në përmbajtje, shembuj dhe role lehtësimi;
- reflektojnë në mënyrë kritike mbi paragjykimet personale dhe normat institucionale.

Puna gjithëpërfshirëse me të rinjtë në këtë fushë shpesh kërkon angazhim aktiv, jo neutralitet.

2.6 Ndërthurja (Intersectionality) dhe barrierat e mbivendosura

Të rinjtë mund të përballen me më shumë se një formë përjashtimi njëkohësisht. Koncepti i ndërthurjes (intersectionality) pranon se faktorë si vendndodhja gjeografike, statusi socio-ekonomik, aftësia e kufizuar dhe identiteti personal shpesh ndërthuren dhe përforcojnë barrierat ndaj pjesëmarrjes.

Një qasje ndërthurëse inkurajon punonjësit rinorë të:

- shmangin mendimin e bazuar në një kategori të vetme;
- njohin disavantazhin kumulativ;
- përshtatin mekanizmat mbështetës në mënyrë të diferencuar;
- reagojnë ndaj realiteteve individuale, dhe jo ndaj etiketave të paracaktuara.



Kjo perspektivë forcon rëndësinë e fleksibilitetit, reflektimit dhe të nxënimit të vazhdueshëm në praktikën e punës me të rinjtë në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Lentja e Përfshirjes	Pengesa të zakonshme	Rreziqet nëse injorohen	Reagimi Gjithëpërfshirës
Të rinjtë NEET	Besimi, qasje/aksesi	Braktisje	Hyrje me prag të ulët
Rinia rurale	Transporti	Pjesëmarrje e parregullt	Aktivitete lokale
Aftësi të kufizuara	Aksesueshmëria	Pjesëmarrje pasive	Formate të shumëfishta
Gjinia & diversiteti	Siguria	Heshtje, vetëpërkrahim	Hapësira të sigurta

Tabela 2: Lentet e përfshirjes dhe barrierat e zakonshme në punën me të rinjtë

2.7 Pyetje reflektuese

Për të mbështetur aplikimin dhe reflektimin kritik, trajnerët inkurajohen të ftojnë pjesëmarrësit të marrin në konsideratë:

- Cilat lente të përfshirjes janë më të rëndësishme në kontekstin tim?
- Cilat grupe janë të nënpërfaqësuar në aktivitetet e mia?
- Cilat pengesa janë strukturore dhe jo individuale?
- Si mund ta përshtat praktikën time pa forcuar stereotipet?

Këto reflektime përgatisin pjesëmarrësit për modulet pasuese, të cilat fokusohen në hapësirat e sigurta, mbrojtjen, metodat e angazhimit dhe dizajnin gjithëpërfshirës si përgjigje praktike ndaj barrierave të identifikuara.

3. Hapësirat e sigurta dhe bazat e mbrojtjes

Ky modul synon të:

- sqarojë konceptin e hapësirave të sigurta në punën rinore;
- prezantojë parimet e mbrojtjes dhe përgjegjësitë që lidhen me detyrimin për kujdes;
- forcojë besimin e punonjësve rinorë në identifikimin dhe adresimin e rreziqeve;
- mbështesë krijimin e mjediseve mësimore gjithëpërfshirëse, respektuese dhe të mbrojtura.

Krijimi i hapësirave të sigurta është një kërkesë themelore për punën rinore gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrja, shprehja dhe të nxënimit mund të ndodhin vetëm kur të rinjtë ndihen të sigurt fizikisht,



emocionalisht dhe shoqërisht. Për këtë arsye, mbrojtja dhe detyrimi për kujdes nuk janë detyra shtesë, por përgjegjësi thelbësore profesionale të punonjësve rinorë dhe trajnerëve.

Ky modul e trajton sigurinë jo si një grup rregullash të ngurta, por si një praktikë aktive dhe të vazhdueshme, që mbështet si pjesëmarrësit, ashtu edhe lehtësuesit.

3.1 Kuptimi i hapësirave të sigurta në punën rinore

Një hapësirë e sigurt në punën rinore i referohet një mjedisi në të cilin pjesëmarrësit ndihen:

- të respektuar dhe të vlerësuar;
- të mbrojtur nga dëmi, diskriminimi dhe ngacmimi;
- të aftë të shprehin veten pa frikë nga gjykimi;
- të sigurt se kufijtë dhe pritshmëritë janë të qarta dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme.

Hapësirat e sigurta nuk përcaktohen vetëm nga mjediset fizike. Një dhomë mund të jetë teknikisht e sigurt, por ndihet e pasigurt nëse pjesëmarrësit përjetojnë përjashtim, mungesë respekti ose pabarazi në pushtet. Prandaj, puna gjithëpërfshirëse me të rinjtë kërkon vëmendje ndaj dimensioneve fizike, emocionale dhe sociale të sigurisë.

Hapësirat e sigurta krijohen përmes:

- komunikimit të qartë;
- lehtësimit respektues;
- marrëveshjeve të përbashkëta të grupit;
- reagimeve të qëndrueshme ndaj sjelljes.

Ato mirëmbahen përmes vëmendjes së vazhdueshme ndaj dinamikave të grupit dhe mirëqenies së pjesëmarrësve.

3.2 Hapësirat e sigurta si bazë për përfshirje

Siguria dhe përfshirja janë thellësisht të ndërlidhura. Të rinjtë që kanë përjetuar diskriminim, përjashtim ose marginalizim mund të jenë veçanërisht të ndjeshëm ndaj mjediseve të pasigurta. Për këta pjesëmarrës, siguria nuk mund të merret si e mirëqenë; ajo duhet të demonstron në mënyrë aktive.

Praktika gjithëpërfshirëse e punës rinore njihet se:

- ndjenja e sigurisë është një parakusht për pjesëmarrje;
- besimi zhvillohet me kalimin e kohës dhe përmes veprimeve të qëndrueshme;
- përfshirja kërkon adresimin e rreziqeve të dukshme dhe të padukshme.



Krijimi i hapësirave të sigurta është, për rrjedhojë, një proces i qëllimshëm dhe i vazhdueshëm, dhe jo një marrëveshje e njëhershme apo një deklaratë hapëse.

3.3 Mbrojtja në punën rinore

Mbrojtja i referohet parimeve, procedurave dhe praktikave të zhvilluara për të mbrojtur të rinjtë nga dëmi dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme kur linden shqetësime. Mbrojtja në punën rinore është njëkohësisht e orientuar drejt parandalimit dhe përgjigjes.

Kornizat e mbrojtjes mbështesin punonjësit rinorë duke:

- sqaruar përgjegjësitë dhe kufijtë profesionalë;
- përcaktuar linja të qarta raportimi dhe procedura veprimi;
- ofruar udhëzime për trajtimin e situatave sensitive;
- mbrojtur si pjesëmarrësit, ashtu edhe stafin.

Mbrojtja zbatohet në të gjitha kontekstet e punës rinore, përfshirë:

- aktivitetet lokale;
- trajnimet dhe shkëmbimet rezidenciale;
- udhëtimet dhe akomodimin;
- hapësirat online dhe digjitale.

Në këtë kuptim, mbrojtja nuk është një dokument statik, por një praktikë aktive që duhet të integrohet në çdo fazë të planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve rinore.

3.4 Detyrimi për kujdes dhe përgjegjësia profesionale

Detyrimi për kujdes (duty of care) përfshin kërkesën etike dhe profesionale që punonjësit rinorë të veprojnë në interesin më të mirë të pjesëmarrësve dhe të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të parandaluar dëmtimin. Kjo nuk do të thotë marrje e përgjegjësisë së plotë për sjelljen personale të çdo pjesëmarrësi, por kërkon ndërgjegjësim, përgatitje dhe reagim të përshtatshëm.

Në praktikë, detyrimi për kujdes përfshin:

- vlerësimin e rreziqeve të mundshme përpara zhvillimit të aktiviteteve;
- sigurimin e mbikëqyrjes dhe mbështetjes së përshtatshme;
- komunikimin e qartë të rregullave, pritshmërive dhe kufijve;
- reagimin e qetë dhe të përgjegjshëm ndaj shqetësimeve ose incidenteve;
- njohjen e rasteve kur është e nevojshme të kërkohet mbështetje shtesë.



Puna rinore gjithëpërfshirëse balancon detyrimin për kujdes me respektimin e autonomisë dhe fuqizimit të të rinjve, duke shmangur si mbrojtjen e tepruar, ashtu edhe neglizhencën.

3.5 Linjat e raportimit dhe reagimi ndaj shqetësimeve

Një nga sfidat më të zakonshme në mbrojtje është të kuptosh çfarë të bësh dhe me kë të flasësh kur diçka ndjehet e çuditshme. Prandaj, puna gjithëpërfshirëse me të rinjtë thekson rëndësinë e procedurave të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur për raportim.

Sistemet efektive të mbrojtjes sigurojnë që:

- punonjësit rinorë të dinë saktësisht se kujt duhet t'i drejtohen në rast shqetësimi;
- procedurat të jenë të lehta për t'u ndjekur dhe të komunikohen paraprakisht;
- konfidencialiteti të respektohet, duke i dhënë gjithmonë përparësi sigurisë;
- përgjegjësia të ndahet dhe të mos mbetet mbi një individ të vetëm.

Kur punonjësit rinorë janë të qartë mbi mënyrën e raportimit të shqetësimeve, kjo jo vetëm që ul ankthin e tyre profesional, por edhe parandalon trajtimin e gabuar të situatave sensitive dhe rrit sigurinë e përgjithshme të mjedisit.

3.6 Kufijtë dhe Sjellja Profesionale

Kuptimi i rëndësisë së kufijve profesionalë është një element kyç për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Kufijtë ndihmojnë si të rinjtë ashtu edhe punonjësit rinorë duke ofruar qartësi dhe parashikueshmëri në marrëdhëniet e tyre.

Zonat kryesore të kufijve përfshijnë:

- Kufijtë emocionalë - Është e rëndësishme të shmanget varësia dhe favoritizmi për të ruajtur marrëdhënie të shëndetshme.
- Kufijtë fizikë - Kjo përfshin respektimin e hapësirës personale dhe sigurimin e pëlqimit në të gjitha ndërveprimet.
- Kufijtë digjitalë - Komunikimi dhe kontakti i përshtatshëm online janë thelbësorë në epokën digjitale të sotme.
- Kufijtë e rolit - Përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe kufizimeve ndihmon të gjithë të kuptojnë vendin e tyre në marrëdhënie.

Vendosja e kufijve të qartë ndihmon në ndërtimin e besimit, minimizon rrezikun e keqinterpretimeve dhe kontribuon në krijimin e një mjedisi pozitiv, mbështetës dhe të respektueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.



3.7 *Mbrojtja në kontekste të ndryshme dhe të lëvizjes (mobilitetit)*

Në mjedise të ndryshme dhe shumëkombëshe, mbrojtja kërkon ndjeshmëri shtesë. Çështje të ndryshme gjuhësore, kulturore, ligjore dhe personale mund të ndikojnë në mënyrën se si siguria dhe rreziku perceptohen ose komunikohen tek pjesëmarrësit.

Praktika gjithëpërfshirëse e mbrojtjes në këto kontekste përfshin:

- ofrimin e informacionit të qartë dhe të aksesueshëm përpara pjesëmarrjes;
- sigurimin që pjesëmarrësit të dinë saktësisht ku dhe si mund të kërkojnë mbështetje;
- vëmendje ndaj dinamikave të pushtetit brenda grupeve;
- përshtatjen e komunikimit sipas nevojave dhe rrethanave të ndryshme.

Në projektet e mobilitetit, mbrojtja duhet të jetë e dukshme, proaktive dhe e integruar në të gjitha fazat e aktivitetit, nga përgatitja, te zbatimi dhe ndjekja pas përfundimit.

3.8 *Pyetje reflektuese*

Për të mbështetur mësimin dhe reflektimin profesional, trajnerët inkurajohen të ftojnë pjesëmarrësit të marrin në konsideratë:

- Çfarë e bën një hapësirë të ndihet e sigurt për pjesëmarrës të ndryshëm?
- Si ndikojnë dinamikat e pushtetit në sigurinë dhe pjesëmarrjen?
- A i njoh procedurat e mbrojtjes në organizatën ose projektin tim?
- Si mund të balancoj kujdesin, përgjegjësinë dhe autonominë e pjesëmarrësve?

Këto reflektime i përgatitin pjesëmarrësit për modulet e mëposhtme, të cilat përqendrohen në metodat e angazhimit dhe projektimin gjithëpërfshirës, duke u bazuar mbi themelet e sigurisë dhe përgjegjësisë profesionale të vendosura në këtë modul.

4. Metodatat e angazhimit dhe të nxënimit joformal

Ky modul synon të:

- prezantojë metoda gjithëpërfshirëse angazhimi të bazuara në parimet e të nxënimit joformal;
- forcojë aftësinë e pjesëmarrësve për të zgjedhur dhe përshtatur metoda për grupe të ndryshme;
- promovojë qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe të përqendruara te pjesëmarrësi;



- mbështesë lehtësimin gjithëpërfshirës përmes fleksibilitetit, zgjedhjes dhe reflektimit.

Metodat e angazhimit luajnë një rol vendimtar në punën rinore gjithëpërfshirëse. Mënyra se si aktivitetet lehtësohen ndikon drejtpërdrejt në kush ndihet i mirëpritur, kush merr pjesë në mënyrë aktive dhe kush mund të tërhiqet. Për këtë arsye, puna rinore gjithëpërfshirëse kërkon që punonjësit rinorë dhe trajnerët të shkojnë përtej supozimit se të gjitha metodat jo-formale janë automatikisht gjithëpërfshirëse, dhe të reflektojnë në mënyrë kritike mbi mënyrën se si metoda të ndryshme përjetohen nga pjesëmarrës të ndryshëm.

Ky modul fokusohet në mënyrën se si të rinjtë angazhohen, dhe jo vetëm në përmbajtjen që ofrohet.

4.1 Të Nxënit joformal si mjet për përfshirje

Të nxënit jo-formal është një koncept kyç në punën rinore, i cili përfshin pjesëmarrje vullnetare, të nxënit përmes përvojës dhe qasje të përqendruara te nxënësi. Këto elemente e bëjnë të nxënit jo-formal veçanërisht të përshtatshëm për praktikën gjithëpërfshirëse, pasi metodologji të tilla lejojnë fleksibilitet në adresimin e stileve dhe nevojave të ndryshme të të nxënit.

Në punën rinore gjithëpërfshirëse, të nxënit joformal:

- vlerëson përvojën si burim të të nxënit;
- njeh mënyra të ndryshme të pjesëmarrjes dhe kontributit;
- mbështet të nxënit përmes reflektimit dhe ndërveprimit;
- redukton marrëdhëniet hierarkike mes lehtësuesve dhe pjesëmarrësve.

Megjithatë, praktika gjithëpërfshirëse kërkon të pranohet se joformal nuk do të thotë automatikisht gjithëpërfshirës. Pa reflektim dhe përshtatje, edhe metodat pjesëmarrëse mund të përjashtojnë të rinj që ndihen të pasigurt, të mbingarkuar ose të paqartë mbi pritshmëritë.

4.2 Pjesëmarrje me zgjedhje dhe angazhim fleksibël

Një parim qendror i angazhimit gjithëpërfshirës është pjesëmarrja vullnetare. Ky parim pranon se pjesëmarrja kuptimplotë nuk mund të imponohet dhe se të rinjtë duhet të kenë autonomi mbi mënyrën se si angazhohen në aktivitete.

Pjesëmarrja me zgjedhje përfshin:

- mundësinë për të vëzhguar pa qenë të detyruar të kontribuojnë aktivisht;
- forma të ndryshme pjesëmarrjeje (të folur, të shkruar, vizatim, lëvizje);
- mundësinë për t'u tërhequr përkohësisht nga aktivitetet kur është e nevojshme;
- komunikim të qartë se pjesëmarrja inkurajohet, por nuk është e detyrueshme.



Angazhimi fleksibël mbështet pjesëmarrësit që kanë nevojë për më shumë kohë për të ndërtuar besim ose siguri, dhe redukton presionin mbi ata që ndihen të shqetësuar ose të paretshëm në mjedise grupore. Kjo qasje kontribuon në sigurinë psikologjike dhe në angazhim të qëndrueshëm në kohë.

4.3 Qasjet e ndjeshme ndaj traumës në punën rinore

Puna rinore gjithëpërfshirëse gjithnjë e më shumë njih rëndësinë e praktikës së vetëdijshme për traumën. Shumë të rinj mund të kenë përjetuar paqëndrueshmëri, diskriminim, përjashtim ose situata të tjera sfiduese jetësore që ndikojnë në reagimet e tyre ndaj aktiviteteve grupore dhe mjediseve të të nxëniet. Një qasje e ndjeshme ndaj traumës në punën rinore nuk kërkon që lehtësuesit të veprojnë si terapistë. Përkundrazi, ajo fokusohet në krijimin e kushteve që minimizojnë dëmtimin dhe mbështesin sigurinë emocionale.

Parimet kryesore të angazhimit të ndjeshëm ndaj traumës përfshijnë:

- parashikueshmëri dhe strukturë të qartë;
- transparencë mbi aktivitetet dhe pritshmëritë;
- pjesëmarrje të bazuar në pëlqim;
- shmangien e metodave që kërkojnë zbulim të detyruar ose ekspozim emocional;
- ofrimin e momenteve për qetësim, reflektim dhe pushime.

Qasjet e ndjeshme ndaj traumës i ndihmojnë punonjësit rinorë të reagojnë me ndjeshmëri ndaj sjelljeve dhe reagimeve të ndryshme, pa i patologjizuar pjesëmarrësit.

4.4 Vlerësimi i metodave të angazhimit përmes lenteve të përfshirjes

Puna rinore gjithëpërfshirëse kërkon reflektim kritik mbi metodat e angazhimit që përdoren zakonisht. Aktivitetet që janë efektive për disa pjesëmarrës mund të përjashtojnë të tjerët pa dashje.

Shembuj të metodave që mund të kërkojnë përshtatje përfshijnë:

- energjizues ose lojëra me intensitet të lartë që mund të mbingarkojnë pjesëmarrës me anktë ose ndjeshmëri sensoriale;
- lojëra konkurruese që mund të dekurajojnë pjesëmarrës me vetëbesim të ulët;
- role-play ose simulime që mund të ndihen të pasigurta për të rinj me përvoja të mëparshme konflikti ose diskriminimi.

Lehtësimi gjithëpërfshirës përfshin pyetje reflektuese si:



- Kush mund të ndihet i parehatshëm me këtë metodë?
- Çfarë supozimesh bën ky aktivitet për vetëbesimin, gjuhën ose aftësinë?
- Si mund të përshtatet metoda për të ofruar pika hyrjeje të shumta?

Kjo qasje reflektuese mbështet marrjen e vendimeve gjithëpërfshirëse dhe përmirëson cilësinë e përgjithshme të aktiviteteve.

4.5 Përshtatja e metodave për nevoja të ndryshme

Përshtatja është një kompetencë kyçe në punën rinore gjithëpërfshirëse. Në vend që të braktisin metodat që paraqesin sfida, punonjësit rinorë inkurajohen t'i modifikojnë aktivitetet në mënyrë që të ruajnë objektivat e të nxënit, duke reduktuar njëkohësisht barrierat ndaj pjesëmarrjes.

Përshtatjet e zakonshme përfshijnë:

- ofrimin e alternativave vizuale ose të shkruara për pjesëmarrjen verbale;
- rregullimin e madhësisë së grupeve për të mbështetur rehati dhe ndërveprim;
- lejimin e afateve kohore fleksibile për realizimin e aktiviteteve;
- thjeshtimin e udhëzimeve dhe verifikimin e vazhdueshëm të kuptimit;
- ofrimin e mbështetjes ose sqarimeve shtesë kur është e nevojshme.

Përshtatja sjell përfitime për të gjithë pjesëmarrësit duke rritur qartësinë, aksesueshmërinë dhe angazhimin.

4.6 Roli i lehtësuesit në angazhimin gjithëpërfshirës

Angazhimi gjithëpërfshirës varet jo vetëm nga metodat, por edhe nga qëndrimet dhe sjelljet e lehtësuesve. Punonjësit rinorë luajnë një rol qendror në modelimin e respektit, përgjegjshmërisë dhe reagimit të ndjeshëm ndaj nevojave të pjesëmarrësve..

Lehtësimi gjithëpërfshirës përfshin:

- vëzhgimin e dinamikave të grupit dhe modeleve të pjesëmarrjes;
- reagimin me qetësi ndaj tërheqjes ose vështirësive në angazhim;
- vlerësimin e kontributeve të ndryshme pa krahasim ose gjykim;
- inkurajimin e mbështetjes reciproke dhe bashkëpunimit mes pjesëmarrësve;
- krijimin e hapësirës për feedback dhe reflektim.

Lehtësuesit inkurajohen të shohin veten si nxënës së bashku me pjesëmarrësit, duke nxitur respekt të ndërsjelltë dhe pronësi të përbashkët mbi procesin e të nxënit.



4.7 Angazhimi në kontekste të ndryshme

Në kontekste ndërkombëtare dhe të bazuara në mobilitet, metodat e angazhimit duhet të marrin parasysh faktorë shtesë si diversiteti gjuhësor, dallimet kulturore dhe nivelet e ndryshme të përvojës së mëparshme të pjesëmarrësve.

Angazhimi gjithëpërfshirës në këto kontekste përfshin:

- përdorimin e gjuhës së qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme;
- mbështetjen e të kuptuarit përmes materialeve vizuale dhe demonstrimeve praktike;
- ndjeshmëri ndaj normave kulturore dhe stileve të ndryshme të komunikimit;
- ofrimin e kontrollit të rregullt (check-in) dhe mundësive për feedback.

Këto konsiderata janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e Trajnimit të Trajnerëve (TOT), ku pjesëmarrësit pritet t'i replikojnë metodat gjithëpërfshirëse në mjediset e tyre lokale.

4.8 Pyetje Reflektuese

Për të mbështetur të nxënit dhe zbatimin praktik, trajnerët inkurajohen t'u kërkojnë pjesëmarrësve të reflektojnë mbi pyetjet e mëposhtme:

- Cilat metoda angazhimi përdor më shpesh?
- Kush ka tendencë të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e mia? Kush merr pjesë më pak?
- Si reagoj kur pjesëmarrësit humbasin interesin ose tërhiqen?
- Çfarë përshtatjesh mund të bëj për t'i bërë metodat e mia më gjithëpërfshirëse?

Këto reflektime i përgatitin pjesëmarrësit për zbatimin praktik të parimeve gjithëpërfshirëse gjatë sesionit praktik, ku metodat e angazhimit dhe zgjedhjet e projektimit gjithëpërfshirës testohen në skenare reale.

5. Projektimi duke marrë parasysh barrierat në punën rinore gjithëpërfshirëse

Ky modul synon të:

- mbështesë pjesëmarrësit në identifikimin e barrierave strukturore dhe praktike ndaj pjesëmarrjes rinore;



- forcojë aftësinë e punonjësve rinorë për të parashikuar barrierat gjatë fazës së planifikimit të aktiviteteve;
- promovojë zgjedhje dizajni gjithëpërfshirëse që reduktojnë përjashtimin e lidhur me transportin, kohën, gjuhën, kostot dhe aksesin;
- përforcojë kuptimin e barrierave si sfida dizajni, dhe jo si mangësi individuale.

Puna gjithëpërfshirëse me të rinjtë kërkon më shumë se vetëm ndërgjegjësime për përjashtimin; ajo kërkon vendime të qëllimshme planifikimi që reduktojnë ose eliminojnë pengesat për pjesëmarrje. Pengesat rrallë shkaktohen nga mungesa e motivimit nga ana e të rinjve. Përkundrazi, ato shpesh janë të ngulitura në mënyrën se si planifikohen, komunikohen dhe zbatohen aktivitetet.

Ky modul fokusohet në njohjen e hershme të barrierave dhe integrimin e zgjidhjeve gjithëpërfshirëse në fazën e projektimit të aktiviteteve rinore.

5.1 *Kuptimi i barrierave si sfida të projektimit*

Në punën rinore gjithëpërfshirëse, barrierat kuptohen si faktorë strukturorë dhe kontekstualë që kufizojnë pjesëmarrjen. Ato mund të jenë të dukshme, si p.sh. mungesa e aksesit fizik, ose më pak të dukshme, si presioni financiar apo mungesa e vetëbesimit e lidhur me përvoja të mëparshme përjashtimi.

Praktika gjithëpërfshirëse zhvendos pyetjen nga:

"Pse të rinjtë nuk marrin pjesë?"

në:

"Çfarë në projektimin e këtij aktiviteti mund ta pengojë pjesëmarrjen?"

Kjo perspektivë vendos përgjegjësinë mbi punonjësit rinorë dhe organizatorët për të reflektuar kritikisht mbi zgjedhjet e tyre të planifikimit dhe për të projektuar aktivitete që i përgjigjen realiteteve të ndryshme të të rinjve.

5.2 *Barrierat e transportit dhe barrierat gjeografike*

Transporti është një nga barrierat më të shpeshta ndaj pjesëmarrjes, veçanërisht për të rinjtë ruralë, të rinjtë NEET dhe ata me burime financiare të kufizuara. Distancat e gjata, mungesa e transportit publik dhe kostot e larta të udhëtimit mund të ndikojnë ndjeshëm në aksesin ndaj aktiviteteve rinore.

Përgjigjet e dizajnit gjithëpërfshirës mund të përfshijnë:

- përzgjedhjen e ambienteve që janë të aksesueshme me transport publik;
- organizimin e aktiviteteve më afër komuniteteve të pjesëmarrësve;
- koordinimin e transportit të përbashkët ose rimbursimin e kostove, kur është e mundur;



- përshtatjen e orareve me disponueshmërinë e transportit;
- konsiderimin e qasjeve të decentralizuara ose të lëvizshme të punës rinore.

Adresimi i barrierave të transportit dërgon një mesazh të qartë se pjesëmarrja vlerësohet dhe mbështetet.

5.3 *Barrierat e Kohës dhe Orarit*

Koha është një faktor kritik që ndikon në pjesëmarrje. Aktivitetet e planifikuara pa marrë parasysh përgjegjësitë e përditshme të pjesëmarrësve mund të përjashtojnë të rinjtë që punojnë me orare të parregullta, ndjekin shkollën, kujdesen për familjarë ose përballen me lodhje apo sfida të shëndetit mendor.

Planifikimi gjithëpërfshirës i orareve përfshin:

- konsultimin me pjesëmarrësit për disponueshmërinë, kur është e mundur;
- ofrimin e orareve fleksibile të fillimit dhe përfundimit;
- përfshirjen e pushimeve dhe ritmit realist të aktiviteteve;
- lejimin e mbërritjeve me vonesë ose largimeve të hershme pa penalizim;
- komunikimin e qartë dhe në kohë të orareve.

Fleksibiliteti në kohë mbështet angazhimin e vazhdueshëm dhe tregon respekt për realitetet jetësore të pjesëmarrësve.

5.4 *Barrierat gjuhësore dhe të komunikimit*

Gjuha luan një rol thelbësor në vetëbesimin, të kuptuarit dhe gatishmërinë e të rinjve për të marrë pjesë. Barrierat gjuhësore mund të lindin si pasojë e njohurive të kufizuara të gjuhës së punës, përdorimit të terminologjisë komplekse ose udhëzimeve të paqarta.

Praktikat gjithëpërfshirëse të komunikimit përfshijnë:

- përdorimin e gjuhës së qartë, të thjeshtë dhe të aksesueshme;
- shmangien e zhargonit dhe shkurtesave të pashpjeguara;
- mbështetjen e udhëzimeve verbale me materiale vizuale ose të shkruara;
- verifikimin e vazhdueshëm të të kuptuarit;
- inkurajimin e mbështetjes mes bashkëmoshatarëve, kur është e përshtatshme.

Komunikimi gjithëpërfshirës synon të sigurojë kuptim të përbashkët, dhe jo të supozojë që informacioni është kuptuar nga të gjithë në të njëjtën mënyrë.



5.5 *Barrierat Financiare dhe Kostot e Fshehta*

Barrierat financiare shpesh shkojnë përtej tarifave të pjesëmarrjes. Kostot e fshehura, si transporti, ushqimi, materialet apo mjetet digjitale, mund të dekurajojnë pjesëmarrjen edhe kur aktivitetet paraqiten si falas.

Qasjet gjithëpërfshirës të projektimit përfshijnë:

- transparencë të plotë mbi të gjitha kostot e mundshme;
- minimizimin e kontributeve financiare të pjesëmarrësve, kur është e mundur;
- sigurimin e ushqimit, materialeve ose rimbursimit të shpenzimeve;
- shmangien e aktiviteteve që kërkojnë pajisje personale të kushtueshme;
- marrjen në konsideratë të ndikimit financiar kumulativ të pjesëmarrjes.

Adresimi i barrierave financiare kontribuon në barazi dhe redukton stresin e pjesëmarrësve.

5.6 *Barrierat e aksesit fizik dhe digjital*

Barrierat e aksesit mund të jenë fizike, digjitale ose një kombinim i të dyjave. Barrierat fizike përfshijnë ambiente ose objekte të papërshtatshme, ndërsa barrierat digjitale lidhen me akses të kufizuar në internet, mungesë pajisjesh ose nivele të ulëta të aftësive digjitale.

Projektimi gjithëpërfshirës i aksesit përfshin:

- përzgjedhjen e ambienteve dhe faciliteteve të aksesueshme;
- ofrimin e informacionit të qartë mbi veçoritë e aksesueshmërisë;
- ofrimin e formateve alternative të pjesëmarrjes, kur është e nevojshme;
- përdorimin e mjeteve digjitale që kërkojnë pak të dhëna ose funksionojnë edhe offline;
- mbështetjen e pjesëmarrësve me nivele të ndryshme aftësish digjitale.

Aksesueshmëria duhet të merret parasysh që në fazat më të hershme të planifikimit, jo si një përshtatje në minutën e fundit.

5.7 *Projektimi me të rinjtë, jo për ta*

Puna rinore gjithëpërfshirëse thekson bashkëprojektimin (co-design) si një parim kyç. Në vend që të supozojnë se cilat barrierë ekzistojnë, punonjësit rinorë inkurajohen të përfshijnë drejtpërdrejt të rinjtë në identifikimin e sfidave dhe në propozimin e zgjidhjeve.

Praktikat e bashkëprojektimit mund të përfshijnë:

- sesione planifikimi pjesëmarrëse;
- mekanizma feedback-u para dhe pas aktiviteteve;



- aktivitete pilot dhe përshtatje të vazhdueshme;
- vendimmarrje të përbashkët, kur është e përshtatshme.

Projektimi së bashku me të rinjtë rrit relevancën, ndjenjën e pronësisë dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve të punës rinore.

5.8 Pyetje reflektuese

Për të mbështetur zbatimin praktik dhe reflektimin kritik, trajnerët inkurajohen t'u kërkojnë pjesëmarrësve të reflektojnë mbi pyetjet e mëposhtme:

- Cilat barrierë janë më të zakonshme në kontekstin tim lokal?
- Cilat zgjedhje dizajni mund të përjashtojnë pa dashje pjesëmarrësit?
- Ku mund të rritet fleksibiliteti pa kompromentuar objektivat e aktivitetit?
- Si mund të përfshihen të rinjtë në identifikimin dhe reduktimin e barrierave?

Këto reflektime përgatisin pjesëmarrësit për të aplikuar parimet e dizajnit gjithëpërfshirës në praktikë, duke kaluar nga analiza në veprim konkret.

5.9 Lista e kontrollit për projektim gjithëpërfshirës të aktiviteteve

Kjo listë kontrolli mbështet punonjësit rinorë dhe trajnerët në rishikimin e planeve të aktiviteteve përmes një lenteje gjithëpërfshirëse. Ajo mund të përdoret gjatë fazave të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit.

A. Aksesit & Logjistika

- A është vendndodhja fizikisht e aksesueshme për të gjithë pjesëmarrësit?
- A është vendndodhja e arritshme me transport publik ose të përbashkët?
- A janë marrë në konsideratë opsione alternative për pjesëmarrje nëse qasja është e kufizuar?

B. Koha & Struktura

- A e merr orari parasysh disponueshmërinë dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve?
- A janë përfshirë pushime për të mbështetur përqendrimin dhe mirëqenien?
- A është pjesëmarrja fleksibile (ardhje e vonuar, vëzhgim, dalje)?

C. Komunikimi & Gjuha

- A ndahet informacioni në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme?
- A mbështeten udhëzimet me materiale vizuale ose të shkruara?
- A verifikohet kuptimi në vend që të supozohet?

D. Pjesëmarrja & Angazhimi



- A ofrohen forma të ndryshme pjesëmarrjeje (verbale, të shkruara, krijuese)?
- A janë metodat e angazhimit të përshtatura për nivele të ndryshme besimi?
- A është pjesëmarrja vullnetare dhe e bazuar në pëlqim?

E. Siguria & Mbrojtja

- A janë vendosur dhe respektuar marrëveshje grupore?
- A janë procedurat e mbrojtjes dhe linjat e raportimit të qarta?
- A monitorohet në mënyrë aktive siguria emocionale dhe psikologjike?

F. Çështjet Financiare & Burimet

- A komunikohen të gjitha kostot e mundshme në mënyrë transparente?
- A ofrohen ose janë të aksesueshme për të gjithë materialet dhe mjetet?
- A minimizohen ose zbusen kostot e fshehta?

Laboratori: Projektimi i aktiviteteve rinore gjithëpërfshirëse

Ky laborator praktik u jep pjesëmarrësve mundësinë të përkthejnë konceptet e prezantuara në Modulet 1–5 në praktikë konkrete të punës me të rinjtë. Përmes ushtrimeve bashkëpunuese, të bazuara në skenarë dhe reflektuese, pjesëmarrësit zbatojnë lente përfshirjeje, parime të mbrojtjes, metoda angazhimi dhe strategji për reduktimin e barrierave në situata reale të punës me të rinjtë. Ai forcon kuptimin se puna gjithëpërfshirëse me të rinjtë nuk arrihet vetëm me teori, por përmes zgjedhjeve të qëllimshme të projektimit, reflektimit kritik dhe adaptimit të vazhdueshëm.

Ky Laborator Praktik mund të zbatohet duke përdorur njërin nga opsionet e mëposhtme të aktiviteteve, në varësi të nevojave të grupit, kohës në dispozicion dhe kontekstit të trajnimit. Të dyja opsionet e aktiviteteve synojnë të arrijnë të njëjtat objektiva të të nxënimit dhe të zhvillojnë të njëjtat kompetenca, duke ofruar qasje metodologjike të ndryshme.

Në fund të Laboratorit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- analizojnë situata të punës rinore duke përdorur lente përfshirjeje;
- identifikojnë barriera strukturore, kontekstuale dhe të padukshme ndaj pjesëmarrjes;
- projektojnë aktivitete rinore gjithëpërfshirëse duke u bazuar në parimet e barazisë së drejtë;
- integrojnë konsideratat e mbrojtjes (safeguarding) dhe hapësirave të sigurta në dizajnin e aktiviteteve;
- reflektojnë në mënyrë kritike mbi rolin e tyre profesional në parandalimin e përjashtimit.

Përmes pjesëmarrjes në laborator, pjesëmarrësit forcojnë:

- aftësitë për projektim gjithëpërfshirës dhe të bazuar në barazi të drejtë;



- kompetencat analitike dhe reflektuese në praktikën e punës rinore;
- aftësitë për planifikim bashkëpunues dhe të nxënie mes bashkëmoshatarëve;
- ndërgjegjësimin etik dhe përgjegjësinë profesionale.

Opsioni 1: Projektimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse bazuar në skenarë

Pjesëmarrësit punojnë në grupe të vogla për të hartuar një aktivitet gjithëpërfshirës për të rinjtë bazuar në skenarë realistikë nga puna rinore. Çdo skenar pasqyron sfidat e zakonshme të përfshirjes që lidhen me aksesin, sigurinë, angazhimin dhe barazinë. Aktiviteti inkurajon pjesëmarrësit të zbatojnë në mënyrë praktike dhe bashkëpunuese lente përfshirjeje, parime të mbrojtjes dhe strategji për reduktimin e barrierave.

Hapi 1: Formimi i grupeve & shpërndarja e skenarëve

Pjesëmarrësit ndahen në katër grupe të vogla (4 persona secili). Çdo grup merr një skenar realist të punës rinore (kartë e printuar).

Skenari A — Rinia NEET në zonat rurale

Ju po organizoni një workshop rinor për të rinjtë NEET që jetojnë në një zonë rurale me:

- transport publik të kufizuar
- akses të ulët digjital
- besim i ulët te institucionet

Skenari B — Grup me aftësi të ndryshme

Ju po lehtësoni një aktivitet lokal rinor me:

- të rinj me dhe pa aftësi të kufizuara
- buxhet i kufizuar
- hapësirë publike të përbashkët

Skenari C — Gjinia & Diversiteti

Ju po planifikoni një hapësirë rinore diskutimi për:

- identitete gjinore të ndryshme dhe prejardhje kulturore të ndryshme
- të rinj me përvoja të mëparshme diskriminimi

Skenari D — Konteksti i Mobilitetit

Po organizoni një trajnim të shkurtër për të rinjtë që marrin pjesë në një projekt mobiliteti ndërkombëtar me:

- gjuhë të ndryshme
- përvojë udhëtimi për herë të parë
- nivele të ndryshme besimi



Hapi 2: Projektimi gjithëpërfshirës i aktivitetit

Çdo grup harton një aktivitet të shkurtër rinor duke u përgjigjur skenarit të tyre. Grupet duhet të përcaktojnë:

1. Grupi i synuar & lëntja e përfshirjes

- Për kë është aktiviteti?
- Cilat lënte të përfshirjes zbatohen?

2. Qëllimi i aktivitetit

- Çfarë duhet të fitojnë pjesëmarrësit (mësim, vetëbesim, lidhje)?

3. Metoda e angazhimit

- Cilat metoda joformale përdoren?
- Pse?

4. Masat e sigurisë dhe mbrojtjes

- Si krijohet një hapësirë e sigurt?
- Cilat kufij ose linja raportimi janë të rëndësishme?

5. Zgjidhje barrierash

Si trajtohen këto çështje në projektim:

- transporti?
- koha?
- gjuha?
- kostot?
- aksesimi?

Hapi 3: Rishikimi nga pjesëmarrësit / kolegët & përfshirja

Çdo grup paraqet aktivitetin e tij (5 minuta për grup).

Pas çdo prezantimi, pjesëmarrësit e tjerë japin komente duke përdorur tre pyetje udhëzuese:

- Çfarë e bën këtë aktivitet gjithëpërfshirës?
 - Cilat pengesa të mundshme mbeten?
 - Çfarë mund të përmirësohet ose përshtatet?
-



Opsioni 2: Hartëzimi i barrierave & riprojektimi gjithëpërfshirës

Pjesëmarrësit punojnë në grupe të vogla për të analizuar një aktivitet ekzistues të punës rinore (ose një që përdoret shpesh) dhe për të identifikuar barrierat ndaj pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse. Bazuar në këtë analizë, grupet riprojektojnë aktivitetin duke përdorur parimet e punës gjithëpërfshirëse me të rinjtë. Aktiviteti fokusohet në njohjen e barrierave strukturore dhe në marrjen e vendimeve të qëllimshme të dizajnit që promovojnë aksesin, sigurinë dhe barazinë.

Hapi 1: Formimi i grupeve & shpërndarja e aktiviteteve

Pjesëmarrësit ndahen në katër grupe të vogla (afërsisht 4 pjesëmarrës për grup).

Çdo grup merr një përshkrim të një aktiviteti të punës me të rinjtë që përfshin sfida të mundshme përfshirjeje.

Aktiviteti A — Workshop i përqendruar në qytet

Ju po organizoni një workshop rinor që mbahet në qendër të qytetit me:

- kohë të fiksuara fillimi dhe përfundimi
- pritjet pjesëmarrje fizike
- pa rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit

Aktiviteti B — Aktivitet lokal me burime të kufizuara

Ju po lehtësoni një aktivitet lokal rinor me:

- një buxhet shumë të kufizuar
- hapësirë publike e përbashkët
- pa pajisje të specializuara

Aktiviteti C — Diskutim mbi një temë të ndjeshme

Ju po planifikoni një aktivitet rinor të bazuar në diskutim që trajton:

- tema sociale ose personale të ndjeshme
- pjesëmarrës me prejardhje kulturore të ndryshme
- nivele të ndryshme të besimit për të folur hapur

Aktiviteti D — Përgatitja për mobilitet

Po përgatitni një grup të të rinjve për një përvojë mobiliteti ndërkombëtar me:

- nivele të ndryshme gjuhësore
- përvojë udhëtimi për herë të parë
- pritshmëri dhe nivele besimi të përziera

Hapi 2: Hartëzimi i barrierave

Çdo grup analizon aktivitetin e caktuar dhe identifikon pengesat e mundshme për pjesëmarrje. Grupet kërkohet të reflektojnë mbi:



- Cilat të rinj mund të kenë vështirësi për të marrë pjesë dhe pse?
- Cilat lente të përfshirjes janë më të rëndësishme?
- Cilat pengesa strukturore ose të lidhura me projektimin janë të pranishme?

Grupet duhet të marrin parasysh barrierat që lidhen me:

- transportin
- koha dhe planifikimi
- gjuha dhe komunikimi
- kostot dhe burimet
- aksesin, sigurinë dhe dinamikën e pjesëmarrjes

Hapi 3: Rishikimi i aktivitetit gjithëpërfshirës

Bazuar në pengesat e identifikuara, çdo grup riprojekton aktivitetin për ta bërë atë më gjithëpërfshirës.

Grupet përcaktojnë dhe justifikojnë elementët e mëposhtëm:

1. Grupi i synuar & lentja e përfshirjes

- Për kë është destinuar aktiviteti i riprojektuar?
- Cilat lente të përfshirjes janë prioritare?

2. Qëllimi i përshtatur i aktivitetit

- Çfarë duhet të fitojnë pjesëmarrësit përmes aktivitetit të riprojektuar?

3. Metoda e përshtatur e angazhimit

- Cilat metoda joformale përdoren ose përshtaten?
- Si mbështesin këto metoda pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse?

4. Masat e sigurisë dhe mbrojtjes

- Si sigurohet një hapësirë e sigurt dhe e respektueshme?
- Cilat kufij ose mekanizma mbështetës janë të rëndësishëm?

5. Masa për reduktimin e barrierave

Si e adreson aktiviteti i riprojektuar barrierat që lidhen me:

- transportin?
- kohën?
- gjuhën?
- kostot?
- qasjen dhe sigurinë?



Hapi 4: Prezantimi & Komentet e bashkëmoshatarëve

Çdo grup paraqet aktivitetin e tyre të riprojektuar. Pas çdo prezantimi, pjesëmarrësit e tjerë japin komente duke përdorur pyetjet udhëzuese të mëposhtme:

- Cilat pengesa u adresuan në mënyrë efektive?
